

VENDIM
Nr. 308, datë 20.7.1992

PËR LIBERALIZIMIN E ÇMIMEVE E TARIFAVE DHE KOMPETENCAT E ÇAKTIMIT
TË TYRE

Në mbështetje të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrisë së Financave, dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Liberalizohen çmimet e artikujve që përfshihen në pasqyrën nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi. Çmimet e shitjes me pakicë të artikujve të tjerë, që nuk përfshihen në këtë pasqyrë mbeten ato që janë në fuqi.

2. Çmimet e artikujve dhe të shërbimeve të karakterit monopol, që përfshihen në pasqyrën nr.2 të bashkëngjitur nuk liberalizohen.

3. Çmimet dhe tarifat që nuk liberalizohen , sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, janë të detyrueshme për zbatim edhe nga personat fizikë e juridikë privatë, vendas ose të huaj.

4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbi bazën e propozimeve ose në bashkëpunim me ministrinë e tjera, ndjek dhe studion periodikisht nivelin e kostos së prodhimit e të shërbimit, fitimin si dhe marzhet dhe rabatet për artikujt, çmimet e të cilëve nuk liberalizohen dhe bën propozimet përkatëse për ndryshimin e tyre.

5. Për artikujt, çmimet e të cilëve liberalizohen, diferencat ndërmjet çmimeve të reja që caktohen pas rivlerësimit dhe atyre të mëparshme, derdhen detyrimisht në buxhetin e shtetit, për sasi të që do të jenë gjendje pranë ndërmarrjeve shtetërore përkatëse nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Organet përkatëse të pushtetit të kontrollojnë kryerjen e inventarizimeve, sistemimin e diferencave dhe derdhjen e tyre në buxhet.

6. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ministrinë e tjera të interesuara nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

7. Vendimet e Këshillit të ministrave nr.199, datë 25.5.1990 "Për kriteret dhe kompetencat e organeve shtetërore për çmimet dhe tarifat", nr.180, datë 17.6.1991 "Për kompetencat e çaktimit të çmimeve dhe të tarifave", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi me 28.7.1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PASQYRA NR. 1
ARTIKUJT, ÇMIMET E TË CILËVE LIBERALIZOHEN

I. Artikuj ushqimore

1. Mish
 2. Qumesht
 3. Gjalp
 4. Djathe
 5. Miell (jo me buken masive)
 6. Makarona
- II. Artikuj jo ushqimore**
Qymyrguri

PASQYRA NR. 2
EMERTESA E ARTIKUJVE DHE E TARIFAVE TE KARAKTERIT MONOPOL, CMIMET E TE
CILEVE NUK LIBERALIZOHEN

1. Nafte e nenprodukte te saj

- Nafte bruto
- Gaz nafte
- Benzine
- Gazoil
- Solar
- Mazut
- Vajguri
- Koks nafte
- Bitum
- Te tjera nenprodukte kryesore

2. Produkte bujqesore

- Grure
- Panxharsheqeri
- Luledielli
- Oriz

3. Avulli teknologjik

4. Energji elektrike (jo per popullin)

5. Uje i pijshem

6. Tarifat e PTT-se

7. Tarifat pyjore

8. Kripe (e zeze e bardhe dhe e jodizuar).

9. Plehra kimike

10. Metalet e cmuara (ari dhe argjendi).